



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 3984 Prot

Shkodër, më 19.02 .2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: “Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 84 datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, projekti ‘Shtëpia që ndërton të ardhmen – Rikonstruksion i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç).

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 3944/Prot

Shkodër, më 19.02.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë _____.2026

“PËR MIRATIM SHITESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR TË MIRATUAR ME VKB NR. 84 DATË 18.12.2025 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2026-2028 TË BASHKISË SHKODËR”, PROJEKTI ‘SHTËPIA QË NDËRTON TË ARDHMEN – RIKONSTRUKSION I SHTËPISË SË FËMIJËS (6-15 VJEÇ)’”

Këshilli i Bashkisë Shkodër sot me datë _____.2026, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; ligjit nr.87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr 02, datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”; Kontratës së Grantit me nr. 2589 Prot., datë 04.02.2026 ndërmjet Ambasadës së Japonisë në Shqipëri dhe Bashkisë Shkodër; VKB nr. 84 datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, pas shqyrtimit të relacionit nr. _____ prot., datë _____ të administratës së Bashkisë Shkodër, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën e planit në Buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 84 datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër” për projektin “Shtëpia që ndërton të ardhmen – Rikonstruksion i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç)”, financuar nga Qeveria e Japonisë nëpërmjet Programit GGP/KUSANONE dhe Bashkisë Shkodër, sipas Kontratës së Grantit nr. Prot. 2589, datë 04.02.2026.
2. Vlera e financimit nga Qeveria e Japonisë (GGP/KUSANONE) është 122,575 euro për rikonstruksion e ambienteve dhe rehabilitimin e mensës, e konvertuar në lek, në vlerë 11,848,099.5 lekë me kursin e këmbimit të datës 02.02.2026, kur është firmosur kontrata e grantit. Vlera e bashkëfinancimit të Bashkisë Shkodër është 4,505,988.9 lekë, duke arritur

në këtë mënyrë buxhetin total të projektit në vlerën 16,354,088.4 lekë, i cili do të zbatohet me llogari brenda thesarit dhe do të përfshihet në programin buxhetor AG141: Përkujdesi Social, aktiviteti P.AG141.Q6.O1.A4 “Shtëpia që ndërton të ardhmen – Rikonstruksion i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç)” me institucion likuidues Bashkinë Shkodër, sipas detajimit:

Buxheti total në lekë

Shpenzimet e llogaritura	Totali	Nga kjo:	
	(Lek)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	16,354,088.4	1,840,608	14,513,480.4
Shuma totale e Projektit	16,354,088.4	1,840,608	14,513,480.4

Buxheti me burim financimi donacion në lekë

Shpenzimet e llogaritura	Totali	Nga kjo:	
	(Lek)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	11,848,099.5		11,848,099.5
Shuma totale (financim nga donatori)	11,848,099.5		11,848,099.5

Buxheti me burim financimi fondet e veta në lekë.

Shpenzimet e llogaritura	Totali	Nga kjo:	
	(Lek)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	2,136,369	1,840,608	295,761
Shuma totale e Bashkëfinancimit	2,136,369	1,840,608	295,761

Shpenzime me burime të veta për TVSH:

Shpenzimet e llogaritura	Totali	Nga kjo:	
	(Lek)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	2,369,619.9		2,369,619.9
Shuma totale e bashkëfinancimit	2,369,619.9		2,369,619.9

Shuma totale e bashkëfinancimit	2,369,619.9	2,369,619.9
---------------------------------	-------------	-------------

3. Bashkia Shkodër do të financojë me fondet e veta: shpenzime operative (Artikulli 602) në vlerën 1,840,608 lekë; shpenzime kapitale të trupëzuara (Artikulli 231), mbikëqyrje dhe kolaudim) në vlerën 295,761 lekë si dhe TVSH në vlerën 2,369,619.9 lekë, në një total prej 4,505,988.9 lekë. Ky fond do të përballohet përmes rialokimit të fondeve të vitit 2025, sipas fishes bashkëngjitur.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Zv. Kryetar

Alban Preko

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar

ELVIN BRAHIMI

Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor

Qerta Haxhi

Drejtoria e Financës

Elvis

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale
dhe Rinisë

Edita Shaska

Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Artënde Xhepa

KRYETAR

Benet BECI

Drejtoria e Përgjithshme Juridike,
Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
Mbështetëse

Drejtoria Juridike

Dr. B. Deppe

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të
Qendrueshëm Ekonomik

Belike Rano

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Stela Mandusha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QENDRUESHËM EKONOMIK

Nr 3944/2 prot.

Shkodër, me 19.02.2026

RELACION

“PËR MIRATIM SHITESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR TË MIRATUAR ME VKB NR. 84 DATË 18.12.2025 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2026-2028 TË BASHKISË SHKODËR”, PROJEKTI ‘SHTËPIA QË NDËRTON TË ARDHMEN – RIKONSTRUKSION I SHTËPISË SË FËMIJËS (6-15 VJEÇ)’”

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Shkodër ka aplikuar pranë Ambasadës së Japonisë në kuadër të Programit të Ndihmën me Grante për Projektet e Sigurisë Njerëzore në Nivelin Lokal (GGP/KUSANONE), me projektin “Shtëpia që ndërton të ardhmen – Rikonstruksion i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç)”.

Pas procesit të vlerësimit, Bashkia Shkodër është shpallur fituese e projektit “*Shtëpia që ndërton të ardhmen*” për vitin 2026, duke u vlerësuar për angazhimin institucional në përmirësimin e kushteve sociale dhe infrastrukturës për fëmijët, përvojën e mëparshme në zbatimin e projekteve të ngjashme dhe gatishmërinë për bashkëfinancim.

Shtëpia e Fëmijës për moshën 6-15 vjeç, e themeluar në vitin 1944, është institucioni më i vjetër rezidencial në territorin e Bashkisë Shkodër. Aktualisht strehohen rreth 30 fëmijë pa kujdes prindëror, si dhe shërbejnë rreth 26 punonjës. Megjithëse ndër vite janë realizuar disa ndërhyrje për përmirësimin e kushteve të brendshme, nevoja për një rehabilitim të mëtejshëm mbetet ende e domosdoshme. Problematikat e evidentuara përfshijnë amortizimin e suvasë dhe dysHEMEVE, praninë e lagështirës në çati, sistem ndriçimi të vjetëruar dhe joefikas, ambiente sanitare të amortizuara, si edhe jo të gjitha hapësirat janë në kushte optimale. Disa nga këto hapsirave perceptohen si të ftohta, jo mikpritëse dhe me nevojë për rinovim.

Qëllimi kryesor i projektit të propozuar është transformimi i këtyre hapësirave në një mjedis më të ngrohtë, më të sigurt dhe funksional, ku fëmijët të mund të zhvillohen, të ndihen si në shtëpi dhe të përfshihen në aktivitetet e përditshme në kushte më komode. Projekti do të fokusohet në rikonstruksionin e infrastrukturës përmes shtrimit të pllakave të reja, instalimit të një sistemi të ri

ndriçimi, rikonceptimit të disa hapësirave specifike si mensa apo ambientet sanitare, si dhe adresimit të problematikave të lagështirës që kanë prekur godinën. Gjithashtu, fasada e jashtme do të lyhet plotësisht.

Zbatimi i projektit “Shtëpia që ndërton të ardhmen” do të realizohet mbi bazën e Kontratës së Grantit me Nr. 2589 Prot., datë 04.02.2026, të nënshkruar ndërmjet Ambasadës së Japonisë në Shqipëri dhe Bashkisë Shkodër, me vlerë financimi 122,575 euro, e konvertuar në lek, në vlerë 11,848,099.5 lekë me kursin e këmbimit të datës 02.02.2026, kur është firmosur kontrata e grantit. Referuar kësaj kontrate, Bashkia Shkodër do të pajisë donatorin me faturë/mandat arkëtimi të lëshuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, për shumën e plotë të grantit të përfituar, si dokument zyrtar që vërteton pranimin e fondeve.

Bashkia Shkodër merr përsipër angazhimin që, brenda vitit 2026, të financojë me fondet e veta: zërin e shpenzimeve “Punime Bojatisje” në vlerën 1,840,608 lekë, (mbikqyrje, kolaudim) në vlerën 295,761 lekë si dhe mbulimin e TVSH-së në vlerën 2,369,619.9 lekë, në një total prej **4,505,988.9** lekë, duke arritur në këtë mënyrë buxhetin total të projektit në vlerën **16,354,088.4** lekë sipas detajimit:

Buxheti total në lekë

Shpenzimet e llogaritura	Totali	Nga kjo:	
	(Lek)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	16,354,088.4	1,840,608	14,513,480.4
Shuma totale e Projektit	16,354,088.4	1,840,608	14,513,480.4

Buxheti me burim financimi donacion në lekë

Shpenzimet e llogaritura	Totali	Nga kjo:	
	(Lek)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	11,848,099.5		11,848,099.5
Shuma totale (financim nga donatori)	11,848,099.5		11,848,099.5

Buxheti me burim financimi fondet e veta në lekë.

Shpenzimet e llogaritura	Totali	Nga kjo:	
--------------------------	--------	----------	--

	(Lek)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	2,136,369	1,840,608	295,761
Shuma totale e Bashkëfinancimit	2,136,369	1,840,608	295,761

Shpenzime me burime të veta për TVSH:

Shpenzimet e llogaritura	Totali	Nga kjo:	
	(Lek)	Shpenzime Operative (602)	Shpenzime kapitale të trupëzuara (231)
Shuma 2026	2,369,619.9		2,369,619.9
Shuma totale e bashkëfinancimit	2,369,619.9		2,369,619.9

Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesarit dhe do të përfshihet në programin AG141: Përkujdesi Social”, me institucion likuidues Bashkinë Shkodër sipas strukturës së shpenzimeve kapitale (artikulli 231 – shpenzime kapitale të trupëzuara) dhe shpenzime operative (artikulli 602) në përputhje me dokumentacionin shoqërues. Projekti “Shtëpia që ndërton të ardhmen – Rikonstrukcion i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç)” përfaqëson një investim të rëndësishëm për Bashkinë Shkodër, i cili kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e standardeve të kujdesit social rezidencial si dhe garantimin e kushteve dinjitoze të jetesës për fëmijët pa kujdes prindëror.

Për këto arsye, kërkohet nga Këshilli Bashkiak miratimi i shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 84 datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër” për projektin “Shtëpia që ndërton të ardhmen – Rikonstrukcion i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç)”, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Ambasadës së Japonisë në Shqipëri, sipas fishes bashkëngjitur.

K R Y E T A R

Benet BECI

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik

Behar Kona

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Stela Shkodra

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Rinisë

Edita Shani

Nr. 51	P.AG141.Q6.O1.A4 “Shtëpia që ndërton të ardhmen – Rikonstruksion i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç)”	Programi AG141 Përkujdesi Social
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Bashkia Shkodër është shpallur fituese me projektin “Shtëpia që ndërton të ardhmen – Rikonstruksion i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç)”, i financuar nga Qeveria Japoneze në kuadër të Programit të Ndihmën me Grante për Projektet e Sigurisë Njerëzore në Nivelin Lokal (GGP/KUSANONE), duke u vlerësuar për angazhimin institucional në përmirësimin e kushteve sociale dhe infrastrukturës për fëmijët, përvojën e mëparshme në zbatimin e projekteve të ngjashme dhe gatishmërinë për bashkëfinancim. Shtëpia e Fëmijës për moshën 6-15 vjeç, e themeluar në vitin 1944, është institucioni më i vjetër rezidencial në territorin e Bashkisë Shkodër. Aktualisht strehohen rreth 30 fëmijë pa kujdes prindëror, si dhe shërbejnë rreth 26 punonjës. Megjithatë ndër vite janë realizuar disa ndërhyrje për përmirësimin e kushteve të brendshme, nevoja për një rehabilitim të mëtejshëm mbetet ende e domosdoshme. Problematikat e evidentuara përfshijnë amortizimin e suvasë dhe dysHEMEVE, praninë e lagështirës në çati, sistem ndriçimi të vjetëruar dhe joefikas, ambiente sanitare të amortizuara, si edhe jo të gjitha hapësirat janë në kushte optimale. Disa nga këto hapsirave perceptohen si të ftohta, jo mikpritëse dhe me nevojë për rinovim.		
Zbatimi i projektit “Shtëpia që ndërton të ardhmen” do të realizohet mbi bazën e Kontratës së Grantit me Nr. 2589 Prot., datë 04.02.2026, të nënshkruar ndërmjet Ambasadës së Japonisë në Shqipëri dhe Bashkisë Shkodër, me vlerë financimi 122,575 euro, e konvertuar në lek, në vlerë 11,848,099.5 lekë me kursin e këmbimit të datës 02.02.2026, kur është firmosur kontrata e grantit. Referuar kësaj kontrate, Bashkia Shkodër do të pajisë donatorin me faturë/mandat arkëtimi të lëshuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, për shumën e plotë të grantit të përfituar, si dokument zyrtar që vërteton pranimin e fondeve. Bashkia Shkodër merr përsipër angazhimin që, brenda vitit 2026, të financojë me fondet e veta: zërin e shpenzimeve “Punime Bojatisje” në vlerën 1,840,608 lekë, (mbikqyrje, kolaudim) në vlerën 295,761 lekë si dhe mbulimin e TVSH-së në vlerën 2,369,619.9 lekë, në një total prej 4,505,988.9 lekë.		
ii. Synimi i projektit		
Qëllimi i projektit është rikonstruksioni i objektit “Shtëpia e Fëmijës (6–15 vjeç)”, me synim transformimin e hapësirave ekzistuese në një mjedis më të ngrohtë, më të sigurt dhe funksional, që garanton kushte më të mira dhe më të përshtatshme për nevojat e tyre zhvillimore.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
- Rikonstruksioni i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç) - Blerje paisje për menses - Lyerje e plotë i fasadës së jashtme për përmirësimin e ambientit estetik.		
b)Rezultatet që prisni		
- Përmirësimi i kushteve të jetesës për fëmijët; - Hapësira më funksionale dhe mbështetëse; - Përmirësim estetik i institucionit dhe psikologjik të fëmijëve.		
c)Aktorët e mundshëm		d)Kontributet e mundshme në projekt
Bashkia Shkodër		Ambasada Japoneze
e) Shpenzimet e llogaritura		

		Totali (lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Rikonstruksion i i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç) (Donatori)	11,848,099.5					11,848,099.5
A.2	Lyerje godine (Punime bojatisje) (burimet e veta)	1,840,608			1,840,608		
A.3	Mbulimi i TVSH (burimet e veta)	2,369,619.9					2,369,619.9
A.4	Mbikqyrje (burimet e veta)	260,576					260,576
A.5	Kolaudim (burimet e veta)	35,185					35,185
	Shuma	16,354,088.4			1,840,608		14,513,480.4
f) Periudha e zbatimit Viti 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Rinisë, Bashkia Shkoder dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					